


ANALIZA E EKONOMISË NË HIJE NË KOSOVË



ANALIZA E EKONOMISË NË HIJE NË KOSOVË

2019

Botues:

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS

Redaktor teknik:

ASHAK

Realizimi kompjuterik:

ASHAK

Madhësia: 12.50 tabakë shtypi

Tirazhi: 200 copë

Formati: 23x28 cm

Shtypi:

Focus Print

Shkup

Katalogimi në botim – (CIP)
Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

33(496.51)(048.8)

Analiza e ekonomisë në hije në Kosovë / ekipi i projektit Isa Mustafa...[et al.].- Prishtinë :
Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, 2019.- 100 f. ; 28 cm.- (ASHAK : Seksioni i
Shkencave Shoqërore)

1.Mustafa, Isa

Titulli paralel në gjuhën angleze.


ISBN 978-9951-26-017-6

ISBN 978-9951-26-017-6



AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS
SEKSIONI I SHKENCAVE SHOQËRORE

ANALIZA E EKONOMISË NË HIJE NË KOSOVË



PRISHTINË
2019

Ekipi i projektit:

Akademik Isa Mustafa

Anëtare Korrespondente Justina Shiroka-Pula

Prof. Assoc. Dr. Besnik A. Krasniqi

Prof. Dr. Arnis Sauka

Dr. Gentril Berisha

Dr. Lekë Pula

MSc. Saranda Lajqi

Dr. Albulena Jaha

Mirënjohje

I jemi mirënjohës Qendrës për Biznes të Qëndrueshëm në SSE Riga për mbështetjen teknike bujare duke na e mundësuar pyetëtorit

PARATHËNIE

Analiza e ekonomisë në hije ose e ekonomisë së fshehur është thelbësore për politikëbërësit në çdo vend të botës. Duke pasur parasysh madhësinë e ekonomisë në hije, rëndësia e matjes së ekonomisë në hije në Kosovë është edhe më e rëndësishme. Në Kosovë, në veçanti, ndërtimi i institucioneve filloi nga e para pas përfundimit të luftës, e cila nga ana tjetër ndikoi në variabëlët e kategorive dhe rrjedhimisht në të ardhurat tatimore që përbëjnë burimin kryesor të financave për qeveritë.

Ky raport për ekonominë në hije bazohet në metodat indirekte të zhvilluara për analizën e ekonomisë në hije, të përdorura për herë të parë nga njëri prej autorëve të studimit, dhe konsiderohet një tregues i rëndësishëm dhe kontribuues në një debat të informuar për madhësinë e ekonomive në hijeve të vendeve përkatëse. Duke marrë parasysh mosmarrëveshjet ekzistuese në literaturën aktuale për analizën e ekonomisë në hije në Kosovë dhe gjetkë, jemi të bindur që ky studim do t'i shtojë debatit ekzistues shkaqet dhe pasojat e ekonomisë në hije në Kosovë.

Shpresojmë që ky studim të luajë një rol të rëndësishëm në forcimin e hartimit të politikave bazuar në dëshmi dhe kështu të rezultojë në krijimin e masave të politikave të zhvilluara enkas për ta luftuar informalitetin.

Raporti i hulumtimit është shkruar nga Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës përmes mbështetjes së jashtme të Qendrës për Biznes të Qëndrueshëm në Shkollën e Ekonomisë së Stokholmit në Riga (Letoni).

Prishtinë, 2019

Autorët

SHKURTESAT

BEEPS	Business Environment and Enterprise Performance Survey Anketa e Mjedisit të Biznesit dhe Performancës së Ndërmarrjeve
BERZH	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
ECA	Europe and Central Asia Evropa dhe Azia Qendrore
BE	Bashkimi Evropian
PBB	Produkti i Brendshëm Bruto
QeK	Qeveria e Kosovës
ILO	International Labor Organisation Organizata Ndërkombëtare e Punës
ASK	Agjencia e Statistikave e Kosovës
OECD	Organisation for Economic Cooperation and Development Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
PCA	Principal Component Analysis Analiza e komponentit kryesor
SNA	System of National Accounts Sistemi i Llogarive Kombëtare
UNDP	United Nations Development Programme Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
TVSH	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar
VIF	Variable Inflated Factor Faktori i Fryrë i Variabëlve

PËRMBAJTJA

PARATHËNIE	1
SHKURTESAT	2
PËRMBAJTJA	3
LISTA E TABELAVE	4
LISTA E FIGURAVE	4
1. HYRJE	5
2. PËRKUFIZIMI I EKONOMISË NË HIJE	6
3. KONTEKSTI I HULUMTIMIT: ANALIZA E EKONOMISË NË HIJE NË KOSOVË.....	7
3.1. Matja e informalitetit në Kosovë	7
3.2. Shkaktarët e informalitetit në Kosovë	10
4. METODAT E PËRDORURA NË NDËRTIMIN E INDEKSIT	11
4.1. Anketimi i ndërmarrësve	11
4.2. Matja e Indeksit të Ekonomisë në Hije	14
5. INDEKSI I EKONOMISË NË HIJE PËR KOSOVËN PËR VITIN 2018	16
5.1. Nënraportimi i të hyrave të biznesit	18
5.2. Nënraportimi i punëtorëve dhe i pagave të tyre	20
6. PËRCAKTUESIT E AKTIVITETIT NË HIJE: REZULTATET E ANKETËS	22
6.1. Karakteristikat e kompanisë dhe ekonomia në hije	22
6.2. Gjasa për tu kapur dhe pasojat e mundshme	25
7. ANALIZA EMPIRIKE.....	26
7.1. Variabëli i varur	26
7.2. Variabëlit e pavarur	26
7.3. Analiza e komponentit kryesor (PCA)	27
7.4. Modeli ekonometrik	28
7.5. Rezultatet	28
8. KONKLUZIONE DHE IMPLIKIMET E POLITIKAVE	32
REFERENCAT	34
SHTOJCA 1: PYETËSORI	37
SHTOJCA 2: KOMPONENTËT E OBSERVUAR DHE TË PAOBSERVUAR TË PBB-SË	45

LISTA E TABELAVE

Tabela 5.1 Raportimi i të hyrave (përqindja e fitimeve reale) në Kosovë dhe ekonomitë e zgjedhura në tranzicion (Matësit si përqindje e të anketuarve të secilit vend që raportohen brenda intervalit të dhënë në kolonën e parë).....	20
Tabela 5.2 Raportimi i numrit të të punësuarve (përqindja e numrit të përgjithshëm të të punësuarve) në Kosovë dhe në ekonomitë e zgjedhura në tranzicion (Matësit si përqindje e të anketuarve të secilit vend që raportohen brenda intervalit të dhënë në kolonën e parë)	21
Tabela 5.3 Raportimi i ulët i pagave (përqindja e pagave aktuale) në Kosovë dhe vendet e zgjedhura	22
Tabela 6.1 Gjasa (probabiliteti) për t'u kapur për raportimin e të hyrave nga biznesi, numrin e të punësuarve, pagat dhe kryerjen e pagesave joformale 'për t'i kryer punët'	25
Tabela 7.1 Matrica e komponentit të rrotulluar	28
Tabela 7.2 Rezultatet e regresionit: Përcaktuesit e përfshirjes së firmave në veprimtarinë në hije	31

LISTA E FIGURAVE

Figura 3.1 Shkalla e informalitetit (punëtorët pa kontrata pune) në vendet e ECA, 2010.....	9
Figura 3.2 Shkalla e informalitetit në vendet evropiane duke përdorur një përkufizim të gjerë të informalitetit	10
Figura 5.1 Indeksi i Ekonomisë në Hijë – Kosova dhe vendet e përzgjedhura.....	17
Figura 5.2 Komponentët e Ekonomisë në Hijë në Kosovë (2018)	18
Figura 5.3 Raportimi i të hyrave nga biznesi (përqindja e fitimeve reale) në Kosovë për vitin 2018 - Krahasimi me vendet e zgjedhura për vitin 2016	19
Figura 5.4 Raportimi i të hyrave nga biznesi (përqindja e fitimeve aktuale) në Kosovë (Aksi vertikal mat përqindjen e të anketuarve që raportohen brenda intervalit të dhënë në boshtin horizontal).....	19
Figura 5.5 Nënraportimi i numrit të të punësuarve (përqindja e numrit aktual të të punësuarve) – Kosova dhe vendet e zgjedhura	20
Figura 5.6 Raportimi i ulët i pagave (përqindja e pagave aktuale) - Kosova dhe vendet e zgjedhura	21
Figura 6.1 Madhësia e ekonomisë në hije (% e PBB-së) sipas sektorit në Kosovë	23
Figura 6.2 Madhësia e ekonomisë në hije (% e PBB) sipas madhësisë së firmës (numri i të punësuarve)	24
Figura 6.3 Nënraportimi i të hyrave nga biznesi, numri i të punësuarve dhe pagat sipas klasës së madhësisë së ndërmarrjes.....	24

1. HYRJE

Analiza e ekonomisë në hije ose e ekonomisë së fshehur është thelbësore për politikëbërësit në matjen e suksesit të tyre në përpjekjet për të zvogëluar madhësinë e saj. Qeveritë e ndryshme synojnë që duke zbatuar politika, masa dhe kontrolle ta zvogëlojnë madhësinë e ekonomisë në hije. Për vendet në tranzicion, siç është Kosova, ekonomia joformale është një temë veçanërisht e rëndësishme, duke marrë parasysh ndryshimin e jashtëzakonshëm institucional me të cilin përballen këto vende (FES, 2013). Në Kosovë, në veçanti, ndërtimi i institucioneve filloi nga e para pas përfundimit të luftës, e cila nga ana tjetër ndikoi në nivelin e lartë të informalitetit dhe rrjedhimisht në të ardhurat tatimore që përbëjnë burimin kryesor të financave për qeverinë. Për shembull, Organizata Ndërkombëtare e Punës - ILO (2018) vlerëson se më shumë se 60 përqind e popullsisë së punësuar në botë janë në ekonominë joformale, shumica e tyre në vendet në zhvillim. Bazuar në të dhënat për vitin 2015, për sa i përket shmangies së taksave, provat sugjerojnë që hendeuku i taksave të BE-së që vjen nga shmangia e taksave të brendshme mund të jetë 825 miliardë euro në vit, (Murphy, 2018).

Përderisa nuk adresohet një shmangie e tillë e taksave ose mosrespektimi i detyrimeve, kjo jo vetëm që kufizon financat publike në dispozicion për të financuar të mirat dhe shërbimet publike, por gjithashtu do të ketë konkurrencë të padrejtë për bizneset që veprojnë në mënyrë formale (Andrews et al., 2011; ILO, 2015 ; OECD, 2012; Williams and Krasniqi, 2017). Për më tepër, literatura tregon se metodat ekzistuese nuk bien dakord për madhësinë e ekonomive në hije në vende të ndryshme, duke shtruar nevojën për dëshmi të mëtejshme. As Kosova nuk përbën përjashtim. Studime të ndryshme tregojnë nivele të ndryshme të informalitetit, bazuar në përkufizime të ndryshme dhe në metodat e përdorura. Për shembull, të dhënat e Bankës Botërore, megjithëse pak të vjetruara, deklarojnë se informaliteti në Kosovë është 40 përqind e PBB-së së vendit (Riinvest, 2013). Studimet më të fundit nga Riinvesti dhe Instituti i Vjenës për Studime Ekonomike Ndërkombëtare sugjerojnë që Kosova është në të njëjtën kategori - 34.4% (Christie and Holzner, 2004).

Në linjë me këtë diskutim, qëllimi i këtij studimi është ndërtimi dhe matja e indeksit të ekonomisë në hije për Kosovën, si dhe eksplorimi i faktorëve kryesorë që ndikojnë në pjesëmarrjen në ekonominë në hije. Ne përdorim termin "ekonomia në hije" për t'iu referuar të gjitha prodhimeve legale të mallrave dhe shërbimeve të prodhuara nga firmat e regjistruara e që fshihen qëllimisht nga autoritetet publike. Studimi është realizuar në bashkëpunim me profesorin Arnis Sauka nga Shkolla e Ekonomisë e Stokholmit në Riga, Letoni. Arnis Sauka dhe Tālis J. Putniņš (2015) e kanë zhvilluar metodologjinë për ta matur madhësinë e ekonomisë në hije bazuar në anketimin e menaxherëve të ndërmarrjeve. Ky indeks dhe shkaqet e pasojat e tij do t'u ofrojnë hartuesve të politikave informata për marrjen e vendimeve bazuar

në dëshmi. Për më tepër, studimi ofron evidencë empirike rreth faktorëve kryesorë përcaktues që ndikojnë te ndërmarrësit; përfshirjen në ekonominë në hije dhe jep disa rekomandime të politikave. Për më tepër, do të ndihmojë në kuptimin e procesit të ndërmarrësisë në Kosovë dhe në krahasimin me vendet e tjera që kanë përdorur këtë metodologji, siç janë vendet e Baltikut, Moldavia, dhe në mes të tjerash Hungaria dhe Polonia.

Kjo qasje bazohet në nocionin se ata që kanë më të ngjarë ta dinë se sa prodhim/të hyra nënraportohen janë ndërmarrësit që vetë përfshihen në keqraportim dhe në prodhim në hije (për diskutim më të hollësishëm shiko Putniņš dhe Sauka, 2015). Për të marrë vlerësime për madhësinë e ekonomive në hije si përpjesë e PBB-së indeksi kombinon vlerësimet e të hyrave të biznesit të raportuara jo saktë, punonjësit e paregjistruar ose të padeklaruar, si dhe pagat 'në zarf' të paraportuara. Metoda e përdorur në këtë raport për vlerësimin e madhësisë së ekonomisë në hije kërkon më pak supozime sesa shumica e metodave ekzistuese, veçanërisht krahasuar me metodat e bazuara në treguesit makro.

Ky raport hulumtues është i organizuar si në vijim. Në seksionin vijues jepet një pasqyrë e përkufizimit të ekonomisë në hije. Seksioni 3 paraqet kontekstin e hulumtimit dhe jep një përmbledhje të literaturës për ekonominë joformale në Kosovë. Seksioni 4 përshkruan metodën për matjen e ekonomisë në hije. Seksioni 5 paraqet vlerësimet e indeksit dhe analizon format e ndryshme të veprimtarisë në hije në Kosovë. Seksioni 6 analizon përcaktorët e përfshirjes së ndërmarrësve në sektorin në hije dhe qëndrimet e tyre për aktivitetet në hije. Seksioni 7 përmban analizën empirike. Së fundmi, seksioni 8 diskuton përfundimet dhe jep disa implikime të politikave.

2. PËRKUFIZIMI I EKONOMISË NË HIJE

Termi ekonomi në hije përkufizohet nga shumë aspekte dhe shpesh i referohen si ekonomi e nëntokës, ekonomi e fshehtë, ekonomi e zezë, ekonomi e padeklaruar, sektor joformal. Pajtueshmëria e këtyre përkufizimeve tregon se aktivitetet që anashkalojnë vëzhgimin, rregullimin ose taksimin nga qeveria konsiderohen pjesë e ekonomisë në hije.

Ky studim përdor termin "ekonomi në hije" për t'iu referuar të gjitha prodhimeve legale të të mirave dhe shërbimeve të prodhuara nga firmat e regjistruara e që fshihen qëllimisht nga autoritetet publike. Studimi e përshtati përkufizimin e Putniņš dhe Sauka (2015) dhe i përgjigjet asaj që Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD), në manualin e tyre gjithëpërfshirës 2002 "Matja e Ekonomisë së Vëzhguar", si dhe Sistemi i Llogarive Kombëtare (SNA 1993) i referohen si "prodhim në nëntokë". Ai është gjithashtu në përputhje me përkufizimet e përdorura nga Schneider, Buehn dhe Montenegro (2010) në një studim të 162 vendeve të Bankës Botërore. SNA (1993) përcakton ekonominë në hije bazuar në disa komponentë, duke përfshirë prodhimin në nëntokë, aktivitetet

e paligjshme, prodhimin e sektorit joformal, prodhimin shtëpiak për konsum vetanak përfundimtar, dhe prodhimin i cili nuk llogaritet për shkak të grumbullimit të pamjaftueshëm të të dhënave. Sidoqoftë, nga lista, prodhimi i fshehtë dhe aktivitetet e paligjshme janë të pamundura për tu matur me anketë se kryesisht mbeten të padukshme (shih Tiszberger, 2019).

Schneider (2012, f. 6) adopton një përkufizim më të ngushtë të ekonomisë në hije, e cila përfshin e gjithë prodhimin ligjor të bazuar në treg të mallrave dhe, të shërbimeve që fshihen qëllimisht nga autoritetet publike për arsytet e mëposhtme:

1. Për të shmangur pagimin e të ardhurave, tatimin në vlerën e shtuar ose tatimet e tjera,
2. Për të shmangur pagimin e kontributeve të sigurimeve shoqërore,
3. Për të shmangur plotësimin e standardeve të caktuara ligjore të tregut të punës, siç janë paga minimale, orari maksimal i punës, standardet e sigurisë, etj., dhe
4. Për të shmangur përmbushjen e detyrimeve të caktuara administrative, të tilla si plotësimi i pyetësorëve statistikorë ose i formularëve të tjerë administrativë.

Indeksi i ekonomisë në hije qysh nga viti 2010 është vlerësuar në vendet e Baltikut (Putniņš dhe Sauka, 2015), në Moldavi, në Rumani (Putniņš, Sauka dhe Davidescu, 2018), dhe së voni edhe për Hungarinë (Tiszberger, 2019) për t'u ofruar politikëbërësve informata për marrjen e vendimeve të arsyeshme të politikave, si dhe për të nxitur të kuptuarin më të thellë të proceseve të ndërmarrësisë dhe të strukturës së ekonomive përkatëse.

Ky përkufizim nuk përfshin aktivitetet e paligjshme të ekonomisë së fshehtë ose krimet klasike si plaçkitjen, grabitjen, shpërndarjen e drogës, etj. Ai gjithashtu përjashton ekonominë joformale shtëpiake e cila përbëhet nga të gjitha shërbimet shtëpiake dhe posaçërisht nga prodhimet për konsumin e tyre përfundimtar.

3. KONTEKSTI I HULUMTIMIT: ANALIZA E EKONOMISË NË HIJE NË KOSOVË

3.1. Matja e informalitetit në Kosovë

Sektori informal që njihet edhe si ekonomia e padeklaruar ose ekonomia në hije është i pranishëm në çdo vend, megjithatë nuk ka konsensus nga studimet se si ta përkufizojnë atë. Strategjia Kombëtare e Kosovës për Parandalimin dhe Luftën Kundër Punës së Padeklaruar, Pastrimit të Parave, Financimit të Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2014-2018 (QeK, 2014), e përkufizon *ekonominë e hirtë të padeklaruar* si tërësi e aktiviteteve që janë të ligjshme, por mbahen të padeklaruar

te autoritetet në përpjekje për të shmangur pagimin e tatimeve ose të kontributeve të sigurimeve shoqërore.

Megjithëse nuk ka asnjë analizë sistematike të informalitetit në Kosovë, vlerësime të ndryshme nga disa raporte dhe studime duke përdorur përkufizime relativisht të ndryshme të konceptit tregojnë një nivel të ngjashëm të informalitetit në Kosovë. Sipas Strategjisë Kombëtare të Kosovës për Parandalimin dhe Luftën Kundër Punës së Padeklaruar, Pastrimit të Parave, Financimit të Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2014-2018, ekonomia e padeklaruar në Kosovë vlerësohet të jetë ndërmjet 26.67% deri 34.75% të PBB-së. Ndërsa, në vlerë monetare varion midis një milion Euro në 2008 dhe 1.7 miliardë Euro në vitin 2012. Një raport i ndryshëm nga Programi i Reformës Ekonomike sugjeron që niveli i ekonomisë së padeklaruar është rreth 32% e PBB-së së vendit (QeK, 2018).

Një vlerësim tjetër nga një projekt i financuar nga BE, "Mbështetje e mëtejshme për Kosovën" realizuar në vitin 2017, vlerësoi se në krahasim me vitin 2013, ekonomia e padeklaruar në Kosovë në 2015 ra me një pikë përqindjeje duke rezultuar në 31.7% të PBB-së. Madhësia e sektorit joformal gjithashtu ra në vlerë absolute nga 1,594 milion € në 2013, në 1,368 milion € në 2015. Në këtë raport janë përdorur metoda indirekte makro që vlerësojnë shtrirjen e sektorit joformal duke llogaritur diferencën midis të ardhurave totale të disponueshme të ekonomive shtëpiake dhe të ardhurave zyrtare (të ardhurat nga tatimi ose të liruara nga taksat). Vlen të theksohet se ekonomia e padeklaruar e vlerësuar përmes kësaj qasjeje është e barabartë me vlerësimin e hendekut total të taksave.

Era Dabla-Norris et al, (2008) sugjerojnë se kur vlerësohet madhësia e ekonomisë joformale është e rëndësishme të vlerësohet madhësia e firmave pasi që kjo është shumë e lidhur me informalitetin. Në Kosovë, punonjësit në firmat e mëdha kanë më shumë të ngjarë të kenë kontrata pune dhe një pjesë e konsiderueshme e të punësuarve në firma të vogla punojnë pa kontrata pune. Një disavantazh i përdorimit të madhësisë së firmave si tregues i madhësisë së sektorit joformal është se shumë firma të vogla funksionojnë zyrtarisht dhe punësojnë vetëm punëtorë zyrtarë ndërsa shumë firma të mëdha përdorin punonjës joformal.

Një vlerësim tjetër i kryer nga Sondazhi i Ndërmarrjeve i Bankës Botërore ka përdorur një anketim të 202 ndërmarrjeve formale private jobujqësore që punësojnë pesë ose më shumë të punësuar. Ky studim tregoi se 94.4% e firmave të anketuara operonin në sektorin formal kur filluan funksionimin e tyre. Sidoqoftë, ata që hyjnë në treg të paregjistruar, mbeten të tillë për 1.5 vjet që është shumë më e lartë në krahasim me mesataren e Evropës dhe të Azisë Qendrore (0.3 vjet).


Bazuar në këtë studim, dy të tretat e firmave formale në Kosovë theksojnë se ato konkurrojnë me firma që operojnë në sektorin joformal e 58.8% theksojnë se praktika e konkurrentëve në ekonominë e padeklaruar është njëri prej kufizimeve

më të mëdha. Në krahasim me rajonin e Evropës dhe të Azisë Qendrore në përgjithësi, këto përqindje janë shumë më të larta (Banka Botërore, 2013).

Kur analizohet aspekti i punësimit në sektorin joformal, duke përdorur përkufizimin e *përgjithshëm*: informaliteti konsiston në punëtorë të papaguar të familjes, punëtorë të vetëpunësuar në firma të vogla, punëtorë të vetëpunësuar në angazhime joprofesionale dhe punëtorë në firma të vogla (pesë ose më pak të punësuar). Duke përdorur këtë përkufizim të punëtorëve joformalë në Kosovë, bazuar në të dhënat e Anketës së Forcës së Punës, informaliteti do të përbëhej nga rreth një e treta e totalit të punëtorëve në tregun e punës. 65 përqindshi i mbetur janë të punësuar formalë. Sidoqoftë, vlen të përmendet se këto shifra mund të mos jenë të sakta duke marrë parasysh që edhe punëtorët e punësuar zyrtarisht mund të marrin "paga të zarfit"¹ për të shmangur tatimin në të ardhura. Ky fenomen është mjaft i përhapur në Evropën Lindore. Kur informaliteti përcaktohet më ngushtë si përqindje e punonjësve me pagë që nuk kanë kontratë pune, vlerësohet se rreth 15% e punëtorëve në Kosovë punojnë në sektorin informal.

Në krahasim me vendet e tjera të Evropës dhe të Azisë Qendrore, bazuar në vlerësimet nga Anketa Jeta në Tranzicion për vitin 2010, Kosova ka një nga nivelet më të larta të informalitetit duke përdorur përkufizimin e ngushtë të punëtorëve të punësuar pa kontrata. Kjo shifër tregon që informaliteti mund të jetë edhe më i lartë se ai i vlerësuar më lart nga LFS.

Figura 3.1 Shkalla e informalitetit (punëtorët pa kontrata pune) në vendet e ECA, 2010




Burimi: Cojocar. 2017, llogaritjet e stafit të Bankës Botërore duke përdorur LITS 2010.

Nëse krahasohet me vendet evropiane, siç paraqitet në figurën 3.1, informaliteti në Kosovë është dukshëm më i lartë se në shumicën e këtyre vendeve dhe rreth dyfish më i lartë se ai i Belgjikës dhe Holandës. Duke përdorur përkufizimin e informalitetit

¹ Pagat e zarfit i referohen një pagese shtesë të padeklaruar të marrë 'nën tryezë' ose 'në zarf'.

si në vijim: "të punësuar në njësi prej 10 ose më pak, punëtorë të vetëpunësuar me ose pa punonjës në angazhime joprofesionale, dhe të gjithë punonjësit e papaguar të familjes", figura 3.2 tregon se vetëm dy vende, Greqia dhe Qiproja, kanë shkallë më të lartë të informalitetit sesa Kosova

Figura 3.2 Shkalla e informalitetit në vendet evropiane duke përdorur një përkufizim të gjerë të informalitetit



Burimi: Cojocar. 2017, figura përdor Databazën e anketës së fuqisë punëtore të BE-së dhe të anketës së fuqisë punëtore në Kosovë (2012).

Në vitin 2013 Riinvest ka zhvilluar një studim për të vlerësuar pagesën e tatimeve nga ndërmarrjet në Kosovë dhe ka zbuluar se menaxherët dhe pronarët e ndërmarrjeve mesatarisht nuk i deklarojnë 37 përqind të të punësuarve të tyre. Sektori i përfshirë kryesisht në informalitet është bujqësia, shëndetësia dhe puna sociale, si dhe ndërtimi, pasi që këta sektorë kryesisht punësojnë punëtorë me aftësi të ulëta dhe punë të rastit, ndërsa në rastin e sektorit të bujqësisë punësohen edhe punëtorë të papaguar të familjes. Megjithatë, shifra e informalitetit në këtë studim mund të jetë edhe më e lartë duke marrë parasysh që ky studim vlerëson punësimin e padeklaruar në ndërmarrjet e regjistruara dhe nuk kap punësimin në ndërmarrjet e paregjistruara, kështu që informaliteti mund të jetë i nënvlerësuar. Duke përdorur të njëjtën bazë të të dhënave, Raporti për Zhvillimin Njerëzor për vitin 2012 i UNDP-së (2013) sugjeron se të punësuarit e padeklaruar në tregun e punës të Kosovës janë rreth 30 deri 40%.

3.2. Shkaktarët e informalitetit në Kosovë

Dështimet dhe papërsosmëria e institucioneve formale krijojnë një asimetri të moralit të shtetit, i cili përbëhet nga ligjet dhe rregulloret, dhe moralit të qytetarit, që përfshin normat, vlerat dhe besimet në lidhje me ligjet dhe rregulloret. Sipas Cojocar (2017), Kosova në krahasim me vendet fqinje renditet më ulët në stabilitetin politik dhe sundimin e ligjit. Korrupsioni i përhapur, çështjet e pazgjidhura të qeverisë dhe mungesa e sundimit të ligjit e kanë ulur moralin e kosovarëve i cili nuk është në përputhje me moralin e shtetit. Paqëndrueshmëria e

vazhdueshme politike dhe mosfunktionimi i qeverisë ka bërë që qytetarët ta humbin besimin në institucionet shtetërore.

Efektiviteti i qeverisë duket se është një përcaktues i rëndësishëm i rritjes së ekonomisë së padeklaruar në Kosovë (Cojojaru, 2017). Në krahasim me vendet fqinje, Kosova renditet në nivelin më të ulët për sa i përket cilësisë së institucioneve, efektivitetit të qeverisë dhe sundimit të ligjit. Indikatorët Mbarëbotërorë të Qeverisjes raportojnë se disa dimensione të sundimit të ligjit dhe të efektivitetit të qeverisë janë përmirësuar nga viti 2010 në 2015, gjatë këtyre viteve ka ende një hendek qeverisjeje në krahasim me përmirësimet në vendet fqinje.

Në lidhje me këtë, nga të dhënat e raportuara nga Krasniqi dhe Williams (2018) nga sondazhi i firmave në Kosovë rezulton se raportimi i ulët i shitjeve të kompanive është dukshëm më i lartë në mesin e firmave më të vogla dhe të reja, dhe firmave në pronësi të burrave. Asnjë asociim domethënës nuk është gjetur ndërmjet dështimeve formale institucionale dhe raportimit të ulët të shitjeve, por ekziston një lidhje statistikisht signifikante midis raporteve të shitjeve të nënraportuara dhe nivelit të besimit vertikal dhe horizontal. Kjo do të thotë që besimi i qeverisë i matur nga perceptimi i korrupsionit luan një rol kryesor në informalitet.

Dështimet institucionale dhe papërsosmëritë zvogëlojnë moralin e qytetarëve dhe zvogëlojnë motivin e tyre për t'u futur në sektorin formal në krahasim me sektorin joformal. Dështimet në institucionet formale që rrisin prevalencën e funksionimit joformal të ndërmarrjeve, ndër të tjera janë: korrupsioni dhe cilësia e qeverisjes; PBB më e ulët për frymë; ulja e shpenzimeve për ndërhyrjet në tregun e punës për të ndihmuar grupet e cenueshme; niveli më i ulët i shpenzimeve sociale; dhe sisteme të transferit social që janë më pak efektive në uljen e nivelit të pabarazisë dhe privimit të rëndë material, i cili përfshin përmirësimin e efikasitetit të grumbullimit.

4. METODAT E PËRDORURA NË NDËRTIMIN E INDEKSIT

4.1. Anketimi i ndërmarrësve

Indeksi i Ekonomisë në Hije bazohet në anketën me ndërmarrës të kryer në vitin 2019 nga Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës, duke ndjekur metodën e Putniç dhe Sauka (2015). Intervistat janë kryer nga anketuesit e trajnuar, studentë të vitit të tretë të Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Prishtinës. Intervistat janë zhvilluar me vendimmarrës kyç në kompani, kryesisht pronarë/menaxherë të ndërmarrjeve.

Anketimi u krye në vitin 2019 në mes të shkurtit dhe marsit dhe përmban pyetje në lidhje me aktivitetin në hije gjatë dy vjetëve të mëparshëm. Studimi përdor mostrimin e shtresuar të rastësishëm për të ndërtuar mostra që janë përfaqësuese të popullsisë së firmave në Kosovë. Mostra është nxjerrë nga regjistri i biznesit të

kompanive të Kosovës i Agjencisë së Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë. Në përputhje me Putniç dhe Sauka (2015) ne formojmë grupe sipas madhësisë (duke përdorur numrin e të punësuarve) dhe duke marrë mostra të barabarta të rastit nga çdo grup sipas madhësisë. Gjithsej, për Kosovën janë realizuar minimum 500 intervista telefonike.

Forma e pyetësorit (shih Shtojcën 1) përmban katër seksione kryesore: (i) ndikimet e jashtme dhe kënaqësinë; (ii) veprimtarinë në hije; (iii) karakteristikat e kompanisë dhe të pronarit; dhe (iv) qëndrimet e ndërmarrësve. Siç sugjeron Putniç dhe Sauka (2015) për ta rritur normën e përgjigjes dhe vërtetësinë e përgjigjeve, pyetësi fillon me pyetje jo të ndjeshme në lidhje me kënaqësinë me politikën qeveritare dhe tatimore, para se të vendosen pyetjet më të ndjeshme në lidhje me aktivitetin në hije dhe keqraportimin e qëllimshëm. Kjo qasje 'graduale' rekomandohet nga studime metodologjike të dizajnit të anketës në kontekstin e evazionit fiskal dhe të ekonomisë në hije (p.sh. Williams and Krasniqi, 2017; Krasniqi and Williams, 2017; Gerxhani, 2007; dhe Kazemier dhe Van Eck, 1992). Më tej, anketa është përshtatur si një studim i kënaqësisë me politikën e qeverisë, në vend se të jetë një studim i evazionit fiskal dhe keqraportimit (i ngjashëm me Hanousek dhe Palda, 2004). Ne gjithashtu të anketuarve u garantojmë 100% konfidencialitet në lidhje me identitetin e tyre.

Në bllokun e parë të anketës, 'ndikimet e jashtme', të anketuarve u kërkohet të shprehin kënaqësinë e tyre me Shërbimin e të Ardhurave Shtetërore, politikën tatimore, legjislacionin e biznesit dhe mbështetjen e qeverisë për ndërmarrësit në vendin përkatës. Pyetjet përdorin një shkallë Likerti prej pesë pikësh, nga "1" ("shumë e pakënaqur") në "5" ("shumë e kënaqur"). Seksioni i parë i pyetësorit gjithashtu përfshin dy pyetje që lidhen me normat sociale të ndërmarrësve: tolerancën e sipërmarrësve ndaj evazionit fiskal dhe ryshfetit. Për shkak të ndjeshmërisë së temës, matësit e tolerancës shërbejnë për një rol të dytë të rëndësishëm si variabël kontrollues për ta kuptuar shtrirjen e aktiviteteve në hije.

Seksioni i dytë i pyetësorit, 'biznesi joformal', është ndërtuar duke u bazuar në konceptet e ndërmarrësisë produktive, joproduktive dhe destruktive nga Baumol (1990), në vlerësimin e 'devijimit' ose të 'largimit nga normat' brenda organizatave (p.sh. Warren, 2003) dhe në studime empirike të evazionit fiskal në mjedise të ndryshme (p.sh. Fairlie, 2002; Aidis dhe Van Praag, 2007; Feld dhe Schneider, 2010; Webb et. al., 2013). Ne e vlerësojmë sasinë e aktivitetit në hije duke u kërkuar ndërmarrësve ta vlerësojnë shkallën e nënraportimit të të ardhurave të biznesit (fitimet neto), nënraportimin e numrit të të punësuarve, nënraportimin e pagave të paguara për punonjësit dhe përqindjen e të hyrave që firmat i paguajnë si ryshfet.

Ne përdorim qasjen 'indirekte' për pyetje në lidhje me biznesin joformal, duke i pyetur ndërmarrësit për 'firmat në industrinë e tyre' në vend se për 'firmën e tyre'. Në vitet e fundit është pranuar se për shkak se pjesëmarrja në ekonominë informale

është shoqërisht e ligjshme nga pikëpamja e institucioneve informale, edhe nëse është e paligjshme për sa i përket institucioneve formale, të anketuarit do të diskutojnë hapur me intervistuesit pjesëmarrjen e tyre (Kazemier, 2014; Williams dhe Krasniqi, 2018).

Prandaj, studime të ndryshme vazhduan t'u bënin të anketuarve pyetje indirekte në lidhje me angazhimin e tyre në ekonominë informale (Williams and Schneider, 2013; Putninš and Sauka, 2015). Kjo qasje diskutohet nga Gerxhani (2007) si një metodë për të marrë përgjigje më të vërteta dhe është e përdorur nga Hanousek dhe Palda (2004). Studimi i realizuar nga Sauka (2008) tregon se edhe nëse pyeten indirekt përgjigjet e ndërmarrësve mund t'i atribuohen të anketuarit ose kompanisë a kompanisë specifike që e përfaqëson i anketuari. Për më tepër, përvoja nga Sauka (2008) sugjeron që intervistat telefonike janë një mjet i përshtatshëm për të nxjerrë informata rreth evazionit fiskal. Në një studim së fundit, Tiszberger (2019) ka përdorur intervista ballë për ballë për të zbatuar llogaritjen e indeksit të ekonomisë në hije bazuar në Putninš dhe Sauka (2015). Sidoqoftë, për shkak të kontekstit specifik të Kosovës dhe bazuar në përvojën paraprake me anketime të ngjashme, ky studim e përdor metodën e intervistimit ballë për ballë.

Pjesa e dytë e pyetësorit gjithashtu mat perceptimet e ndërmarrësve për mundësinë e kapjes në forma të ndryshme të veprimtarisë në hije dhe ashpërsinë e ndëshkimeve nëse dikush keqraporton me qëllim. Përveç matjes së përfshirjes në ekonominë në hije të bizneseve të regjistruara, ne përfshijmë një pyetje që mat sasinë e biznesit të peregjistruar. Ne ua shtrojmë pronarëve/menaxherëve e bizneseve të regjistruara pyetjen e mëposhtme (shiko pyetjen 12 në Shtojcën 1):

"Në disa industri, përveç ndërmarrjeve të regjistruara siç është juaja, funksionojnë edhe ndërmarrjet e peregjistruara, por nuk raportojnë asnjë nga aktivitetet e tyre tek autoritetet. Sipas mendimit tuaj, çfarë përqindje e prodhimit të përgjithshëm të mallrave/shërbimeve të industrisë suaj kryhet nga ndërmarrjet e peregjistruara ...?"

Edhe pse ua bëjmë këtë pyetje pronarëve/menaxherëve të bizneseve të regjistruara, ne besojmë se duke qenë ekspertë në industrinë e tyre ata mund të dinë përafërsisht sa biznese të peregjistruara veprojnë në industrinë e tyre. Kompanitë e regjistruara konkurrojnë me ato të peregjistruara dhe prandaj duhen të jenë të vetëdijshëm për kompani të tilla.

Ne nuk e përfshijmë prodhimin e bizneseve të peregjistruara në indeksin e ekonomisë në hije pasi aktiviteti i tyre nuk përshtatet me përkufizimin tonë për ekonominë në hije. Sidoqoftë, duke përfshirë pyetjen 12, ne jemi në gjendje të japim një pasqyrë më të thelluar të ekonomisë së pavrojtuar në Kosovë. Siç ilustron në Shtojcën 2, pjesët kryesore të ekonomisë së pavrojtuar janë:

1. Të ardhura të paraportuara nga prodhuesit e regjistruar. Kjo është ajo që ne i referohemi si 'ekonomi në hije' dhe e matim me Indeks tonë vjetor që nga viti 2010.
2. Të ardhura të paraportuara nga prodhuesit e paregjistruar. Ky komponent është matur që nga viti 2013 dhe nuk është i përfshirë në Indeks.
3. Të ardhura nga prodhimi i mallrave/shërbimeve të paligjshme. Ne nuk e matim këtë komponent të ekonomisë së pavrojtuar pasi kërkon metoda të ndryshme.

Seksioni i tretë i pyetësorit i pyet ndërmarrësit në lidhje me performancën e kompanisë së tyre (ndryshimi në përqindje të fitimit neto të shitjeve, qarkullimi i shitjeve dhe punësimi gjatë vitit të mëparshëm), moshën e kompanisë, industrinë dhe rajonin.

Seksioni i katërt i pyetësorit i merr mendimet dhe qëndrimet e ndërmarrësve për evazionin fiskal. Këtë vit ne kemi përfshirë pyetje shtesë në lidhje me moralin e ndërmarrësve për tatimin. Ne bazohemi te Torgler dhe Schneider (2009) të cilët e përcaktojnë moralin e taksave si një detyrim moral për të paguar tatime dhe "një besim për të kontribuar në shoqëri duke paguar taksat" (Torgler dhe Schneider 2009: 230). Qasje të ngjashme përdorim edhe për pyetje të tjera që kanë të bëjnë me evazionin fiskal, ne e shtrojmë indirekt pyetjen e moralit tatimor, duke kërkuar nga menaxherët e ndërmarrjeve të deklarojnë në çfarë mase ata do të pajtoheshin ose nuk do të pajtoheshin me deklaratën: "Kompanitë në industrinë tuaj do të mendojnë se është gjithmonë e justifikuar të mashtrojnë për tatimet nëse u vjen mundësia" duke përdorur shkallën nga 1 ("nuk pajtohem fuqishëm") deri në 5 ("pajtohem fuqishëm"). Ne gjithashtu përfshijmë një pyetje mbi përkatësinë në komunitet (Q22c) dhe pyetje mbi kontributin e perceptuar në rritjen e ekonomisë dhe shoqërisë në përgjithësi (Q22a), që të dy faktorë të lidhur me moralin e tatimeve.

Në studimin e këtij viti, ne gjithashtu përfshijmë pyetje nga Anketa e Mjedisit të Biznesit dhe Performancës së Ndërmarrjeve (BEEPS) të zhvilluar nga Banka Botërore/Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) për të matur ndikimet mjedisore siç janë institucionet. Ne i pyesim të anketuarit se në çfarë mase ndikojnë faktorë të tillë si administrata tatimore, niveli i tatimeve, rregullat e tregtisë dhe doganave, licencimi i biznesit dhe lejet, funksionimi i gjyqësorit /gjykatave, pasiguria në lidhje me politikën rregullatore, korrupsionin, praktikën antikonkurrense të konkurrentëve të tjerë dhe paqëndrueshmërinë politike që ndikon në operacionet aktuale të një biznesi (Q23).

4.2. Matja e Indeksit të Ekonomisë në Hijë

Indeksi mat madhësinë e ekonomisë në hije si përqindje e PBB-së. Ekzistojnë tri metoda të zakonshme të matjes së PBB-së: qasja e prodhimit, e shpenzimeve dhe

e të ardhurave. Indeksi ynë bazohet në qasjen e të ardhurave, e cila llogarit PBB-në si shuma e pagës bruto të punonjësve (të ardhurat bruto personale) dhe të ardhurat operative bruto të firmave (të ardhurat bruto të korporatave). Llogaritja e Indeksit vijon në tre hapa: (i) vlerësimi i shkallës së raportimit të pagave të punonjësve dhe raportimi i të ardhurave operative të firmave duke përdorur përgjigjet e anketës; (ii) vlerësimi i prodhimit në hije të secilës firmë si një mesatare e ponderuar të pagës së raportuar të punonjësve të saj dhe të ardhurave operative të nënraportuara, me peshat që pasqyrojnë proporcionet e shpërblimit të punonjësve dhe të ardhurat operative të firmave në përbërjen e PBB-së; dhe (iii) llogaritja e një mesatareje të ponderuar të prodhimit të hijeve në të gjithë firmat.

Në hapin e parë, raportimi i të ardhurave nga ndërmarrja, $UR_i^{Operatingincome}$, vlerësohet drejtpërdrejt nga pyetja përkatëse e anketës (pyetja 7). Megjithatë, raportimi i pagave të punonjësve përbëhet nga dy komponentë: (i) raportimi i pagave, ose 'rrogat e zarfeve' (pyetja 11); dhe (ii) punonjës të paraportuar (pyetja 9). Duke i kombinuar dy përbërës, pjesa totale e paraportuar e shpërblimit të punonjësve të firmës është:

$$UR_i^{Employeere remuneration} = 1 - (1 - UR_i^{Salaries})(1 - UR_i^{Employees})$$

Në hapin e dytë, për secilën firmë ne ndërtojmë një mesatare të ponderuar të të ardhurave të korporatës dhe të ardhurave personale të nënraportuara, duke prodhuar një vlerësim të përpjesës së paraportuar (në hije) të prodhimit (të ardhurave) të firmës:

$$\begin{aligned} \text{Shadowproportion}_i \\ = \alpha_c UR_i^{Employeere remuneration} + (1 - \alpha_c) UR_i^{Operatingincome} \end{aligned}$$

ku α_c është raporti i shpërblimit të punonjësve (bazuar në pjesën e llogarive kombëtare, i cili është zëvendësues i munguar i informacionit për Kosovën në pikën D.1 të Eurostat) me shumën e shpërblimit të punonjësve dhe të ardhurave bruto të operacioneve të firmave (bazuar në të dhënat e Administratës Tatimore për të zëvendësuar pikat e Eurostat B.2g dhe B.3g). Siç sugjerohet nga Putniš dhe Sauka (2015) marrja e një mesatareje të ponderuar të matësve të raportimit sesa të një mesatareje të thjeshtë është e rëndësishme për të lejuar që Indeksi i Ekonomisë në Hijë të interpretohet si një pjesë e PBB-së.

Në hapin e tretë të metodologjisë Putniš dhe Sauka (2015), merret një mesatare e ponderuar e prodhimit të nënraportuar $\text{Shadowproportion}_i$, nëpër firmat në vend c (në rastin tonë është vetëm një vend – Kosova) për të arritur te Indeksi i Ekonomisë në Hijë për atë vend:

$$INDEX_C^{Shadow\ economy} = \sum_{i=1}^{N_c} w_i \text{Shadowproportion}_i$$

Peshat w_i janë kontributi relativ i secilës firmë në PBB-në e vendit, të cilën e vlerësojmë me përafërsi përmes shumës relative të pagave të paguara nga firma. Ngjashëm me hapin e dytë, pesha në këtë mesatare përfundimtare është e rëndësishme për të mundësuar që Indeksi i Ekonomisë në Hije ta pasqyrojë përpjesën e PBB-së.

5. INDEKSI I EKONOMISË NË HIJE PËR KOSOVËN PËR VITIN 2018

Megjithëse pyetjet në lidhje me evazionin fiskal në përgjithësi janë të shoqëruara me shkallë të lartë të mospërgjigjes, në rastin tonë ne arritëm shkallën e përgjigjes më të lartë se 88 përqind për raportimin e pagave, raportimin e të ardhurave dhe të punësuarve. Shkalla e lartë e përgjigjes shton vlefshmërinë e rezultateve tona dhe rrit vlerësimin e precesionit të ekonomisë në hije në Kosovë.

Bazuar në metodologjinë e prezantuar në Seksionin 3, vlerësohet që indeksi i ekonomisë në hije për Kosovën në vitin 2018 është 39.5 përqind. Bazuar në këtë vlerësim, madhësia e ekonomisë në hije është rreth 39 përqind e PBB-së. Duke marrë parasysh që PBB-ja e Kosovës me çmime aktuale në vitin 2018 ishte 6 725.9 milion euro, ekonomia në hije është rreth 2.66 miliardë euro në vit, që është më e lartë se buxheti vjetor i shtetit.²


Të dhënat zyrtare për tregun e hirtë mungojnë; megjithatë, të dhënat e Bankës Botërore, megjithëse pak të vjetruara, tregojnë se informaliteti në Kosovë është 40 përqind e PBB-së së vendit. Në vlerë monetare, kjo është rreth 2 miliardë euro. Nga ky numër, ne shohim se buxheti i shtetit humbet më shumë se 300 milionë euro në vit (thjesht duke llogaritur TVSH; Riinvest, 2013).

Figura 5.1 ilustron indekset e ekonomisë në hije për vendet e zgjedhura (madhësia e ekonomive në hije si përpjesë e PBB-së) duke përdorur metodën e Putniqsh dhe

² Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), PBB-ja e Kosovës me çmime aktuale në vitin 2018 ishte 6 725.9 milion euro. Rritja reale në 2018, në krahasim me vitin 2017, ishte 3.82%, ndërsa PBB për frymë për vitin 2018 ishte 3 746 euro. ASK (2019) raporton se rritja reale në vitin 2018 ishte në aktivitetet vijuese ekonomike: Aktivitetet financiare dhe të sigurimeve (17.9%); administrata publike dhe mbrojtja; sigurimi i detyrueshëm shoqëror (9.5%); ndërtimi (9.3%); aktivitetet shëndetësore dhe të punës sociale (8.1%); tregtia me shumicë dhe pakicë, riparimi i automjeteve dhe motoçikletave (7.6%); informacioni dhe komunikimi (5.1%); industria minerare (4.2%); transporti dhe ruajtja (4.1%); arsimit (3.9%); aktivitete administrative dhe mbështetëse (3.9%); industria e përpunimit (3.4%); hotele dhe restorante (2.9%); biznesi i pasurive të patundshme (2.8%); aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike (2.7%); arti, argëtimi dhe rekreacioni (2.3%); shërbime të tjera (1.4%); dhe furnizimi me ujë (0.6%). Bazuar në ASK, rritja reale nga komponentët kryesorë të PBB-së me qasjen e shpenzimeve për vitin 2018 ishte: Importi i shërbimeve (22.5%); Shpenzimet e konsumit përfundimtar të qeverisë (8.9%); importi i mallrave (6.5%); formimi i kapitalit fiks bruto (6.1%); eksporti i shërbimeve (5.5%); shpenzimet e konsumit përfundimtar të familjes (4.8%); shpenzimet e konsumit përfundimtar të NSIPSH (4.0%).

Sauka (2015). Bazuar në të dhënat për madhësinë e përgjithshme të ekonomive në hije, Kosova ka indeksin më të lartë të ekonomisë në hije, e ndjekur nga Rumania, Moldavia dhe Polonia (25-33%). Shtetet e Baltikut (Estonia, Letonia dhe Lituania) kanë indeks të ulët të ekonomisë në hije (zënë 15-20% të PBB-së).


Figura 5.1 Indeksi i Ekonomisë në Hije – Kosova dhe vendet e përzgjedhura



Burimet: për Moldavinë dhe Rumaninë: Davidescu, 2018; për Estoninë, Letoninë dhe Lituanië: Putniņš dhe Sauka (2017); për Poloninë: Lechman dhe Nikulin, 2018; për Kosovën: autorët.

Për të ilustruar më mirë burimet e ekonomisë në hije në Kosovë ne kemi vlerësuar përbërësit e ekonomisë në hije. Figura 5.2 ilustron madhësinë relative të komponentëve të ekonomisë në hije për vitin 2018 në Kosovë. Komponentët më të mëdhenj të ekonomisë në hije janë të hyrat nga biznesi i pareportuar (47.5%) dhe numri i paraportuar i të punësuarve (28.5%), ndërsa përbërësi i fundit është paga e zarfit 24%. Të marra së bashku, nënraportimi që vjen nga nënraportimi i numrit të të punësuarve dhe pagave të zarfit janë pak më të larta sesa nënraportimi i të hyrave nga biznesi (52.5%).

Figura 5.2 Komponentët e Ekonomisë në Hije në Kosovë (2018)




Burimi: Anketa e ASHAK-ut, 2019: autorët

Seksionet vijuese raportojnë gjetjet nga anketimi mbi raportimin e të ardhurave nga biznesi dhe numrin e të punësuarve në Kosovë. Për më tepër, raporti e vendos Kosovën në kontekst krahasues me vendet që kanë kaluar përvoja të ngjashme në rrugën e tyre drejt ndërtimit të ekonomisë së tregut. Përdorimi i të njëjtit instrument hulumtues në studimet e mëparshme përbën mundësi unike për këtë krahasim.

5.1. Nënraportimi i të hyrave të biznesit

Figura 5.3 ilustron përpjesën e raportimit të të ardhurave nga biznesi (fitimet) që fshihen qëllimisht nga autoritetet në Kosovë në vitin 2018 në krahasim me vendet e tjera në vitin 2016. Në Kosovë, 35.8 përqind e të ardhurave nga biznesi janë të raportuara. Sipas Krasniqit dhe Williamsit (2018) që raportojnë të dhëna nga një studim i vitit 2013 në Kosovë që përfshin 500 intervista ballë për ballë me pronarë të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, 35.7 përqind e shitjeve vlerësohet të jenë të raportuara, gjë që është shumë afër vlerësimeve tona, duke konfirmuar besueshmërinë e këtij studimi. Kjo është shumë e lartë në krahasim me Moldavinë, Rumaninë, Estoninë, Lituaninë dhe Letoninë. Rumania me 31.5 përqind të të ardhurave nga raportimi i biznesit është afër, por gjithsesi shumë më e ulët se Kosova.


Figura 5.3 Raportimi i të hyrave nga biznesi (përqindja e fitimeve reale) në Kosovë për vitin 2018 - Krahasimi me vendet e zgjedhura për vitin 2016



Burimi: Për Moldavinë dhe Rumaninë: Davidescu, 2018; për Estoninë, Letoninë dhe Lituaninë: Putniņš dhe Sauka (2017); për Kosovën: autorët.

Për qëllime të politikave, është interesante të analizohet përqindja e të anketuarve që raportojnë brenda intervalit nga 1-100%. Të dhënat e ilustruara në Figurën 5.4 tregojnë se vetëm 3.2 përqind e të anketuarve deklarojnë se 100% e fitimeve reale u janë raportuar autoriteteve që është jashtëzakonisht e ulët në krahasim me vendet e tjera (shiko Tabelën 5.1).

Figura 5.4 Raportimi i të hyrave nga biznesi (përqindja e fitimeve aktuale) në Kosovë (Aksi vertikal mat përqindjen e të anketuarve që raportohen brenda intervalit të dhënë në boshtin horizontal)



Burimi: Për Moldavinë dhe Rumaninë: Davidescu, 2018; për Estoninë, Letoninë dhe Lituaninë: Putniņš dhe Sauka (2017); për Kosovën: autorët.

Në Moldavi për shembull, afërsisht 29% e të anketuarve deklaruan se raportimi 'në industri' në vitin 2016 ishte 0%, d.m.th., që kompanitë raportuan 100% të fitimeve të tyre reale ndërsa në Rumani vetëm 13.8%, ose përqindje aq e lartë sa 42% në Estoni. Shumica e të anketuarve në Kosovë, rreth 35 përqind deklaruan se 11% -30% dhe 30 përqind e të anketuarve deklaruan se 31-50% e të ardhurave faktike ishin fshehur nga autoritetet. Kjo është më e lartë krahasuar me të gjitha vendet në Tabelën 5.1. Sidoqoftë, për sa i përket raportimit të raporteve ndërmjet intervalit 76-100% Kosova i ka rezultatet më të mira se Moldavia dhe Rumania, por ka raportim më të lartë krahasuar me vendet e Baltikut.

Tabela 5.1 Raportimi i të hyrave (përqindja e fitimeve reale) në Kosovë dhe ekonomitë e zgjedhura në tranzicion (Matësit si përqindje e të anketuarve të secilit vend që raportohen brenda intervalit të dhënë në kolonën e parë)


Shkalla e nënraportimit të të hyrave të biznesit (në %)	Moldavia	Rumania	Estonia	Lituania	Letonia	Kosova
Aspak nënraportim	28.8	13.8	42.5	12.5	21.0	3.2
1-10	12.5	20.7	22.8	48.0	27.5	14.8
11-30	16.7	16.2	24.8	31.5	33.6	33.5
31-50	15.9	15.2	7.1	7.0	12.9	29.4
51-75	4.2	6.7	1.2	0.4	3.1	15.0
76-100	6.4	10.5	1.6	0.7	2.0	4.0

Burimi: Për Moldavinë dhe Rumaninë: Davidescu, 2018;
për Estoninë, Letoninë dhe Lituaninë: Putniņš dhe Sauka (2017);
për Kosovën: autorët.

5.1. Nënraportimi i punëtorëve dhe i pagave të tyre

Figura 5.5 ilustron se niveli i raportimit të numrit të të punësuarve është 35.1 përqind. Kjo shifër është shumë më e lartë në krahasim me Moldavinë (18.7) dhe Rumaninë (20.8). Vendet e Baltikut kanë nivele shumë më të ulëta të raportimit të numrit të të punësuarve - të gjitha e kanë më të ulët se 7 përqind.

Figura 5.5 Nënraportimi i numrit të të punësuarve (përqindja e numrit aktual të të punësuarve) – Kosova dhe vendet e zgjedhura



Burimi: Për Moldavinë dhe Rumaninë: Davidescu, 2018;
për Estoninë, Letoninë dhe Lituaninë: Putniņš dhe Sauka (2017);
për Kosovën: autorët.

Në kontekst krahasues, Kosova ka nivelin më të lartë të raportimit në secilin grup. Në veçanti, dallimet mund të vërehen në kushte të raportimit zero. Të gjitha vendet në Tabelën 5.2, variojnë nga 23 deri në gati 4 përqind e të anketuarve që deklarojnë zero raportim të ulët në krahasim me Kosovën vetëm 7 përqind. Kjo kërkon nevojën për masa të politikave për ta adresuar informalitetin e përhapur.


Tabela 5.2 Raportimi i numrit të të punësuarve (përqindja e numrit të përgjithshëm të të punësuarve) në Kosovë dhe në ekonomitë e zgjedhura në tranzicion (Matësit si përqindje e të anketuarve të secilit vend që raportohen brenda intervalit të dhënë në kolonën e parë)

Shkalla e nënraportimit të numrit të të punësuarve (në %)	Moldavia	Rumania	Estonia	Lithuania	Letonia	Kosova
Aspak nënraportim	39.6	23.3	45.2	34.3	42.0	7.1
1-10	14.7	20.2	33.9	48.9	34.2	15.6
11-30	13.9	18.8	15.4	13.3	15.7	29.2
31-50	12.3	10.5	4.8	3.2	6.6	30.9
51-75	3.4	2.9	0.3	0.3	0.3	13.2
76-100	4.4	4.3	0.3	0.0	1.3	4.1

Burimi: Për Moldavinë dhe Rumaninë: Davidescu, 2018; për Estoninë, Letoninë dhe Lituanië: Putniņš dhe Sauka (2017); për Kosovën: autorët.

